

## Kontratë shitje kuote të kapitalit

Datë 03.09.2022

**Shitës:** Edmond Shahini, biri i Skënder, dtl. 21.04.1975, me adresë banimi në Durrës, lagja Kodër Vilë, mbajtës i letërnjoftimit ID H50421170A, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, që vepron në cilësinë e ortakut 100% të kuotës së kapitalit të shoqërisë “EUROCAR Rentals” shpk, NUIS L71607505F, me seli në Durrës, Autostrada DR-TR, km. 6, person juridik i të drejtës shqiptare, i themeluar më datë 03.03.2017, cka provohet sipas ekstraktit të shoqërisë, lëshuar nga QKB

**Blerës:** Indrit Lama, biri i Shaqir, dtl. 22.02.1976, me adresë banimi në Durrës, lagja 18, Rr. Aleksandër Goga, P. 885, mbajtës i letërnjoftimit ID H60222219N, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

B. LIGJORE: Kodi Civil neni 79, 420, 422, 705; Ligji nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” neni 12, 68, 72, 73, 74 i ndryshuar me Ligjin nr. 129/2014, neni 10;

### Neni 1

#### Objekti i Kontratës

1.1 Përmes kësaj kontrate, bazuar në Vendimin e Asamblesë së shoqërisë, shitësi transferon me shitje pronësinë në masën e 100% të kuotës së kapitalit të shoqërisë “EUROCAR Rentals” shpk, me NUIS L71607505F, në favor të blerësit z. Indrit Lama, kundrejt cmimit 1,000,000.00 (një million) lekë.

### Neni 2

#### Të drejtat dhe detyrimet e palëve

2.1 Pala blerëse e fiton pronësinë mbi kuotën e kapitalit në castin e lidhjes së kontratës noteriale. Cmimi i shitjes do të paguhet në rrugë bankare nga blerësi brenda datës 30.09.2022.

2.2 Me lidhjen e kontratës, pala shitëse z. Edmond Shahini transferon tërësisht pronësinë (në masën 100%) mbi kuotën e kapitalit të shoqërisë “EUROCAR Rentals” shpk, me NUIS L71607505F, në favor të palës blerëse z. Indrit Lama, i cili bëhet ortak i vetëm i shoqërisë në masën 100% të kuotës së kapitalit.

2.3 Kushte të vecanta të shitjes së biznesit mund të hartohen në Aneks të posacëm, që janë pjesë integrale e kësaj kontrate.

2.4 Me nënshkrimin e kontratës, pala blerëse deklaron se është njohur tërësisht me dokumentacionin teknik, financiar dhe ligjor të shoqërisë, ka kryer verifikimet sipas një diligjence të plotë, ka marrë në dorëzim dokumentacionin, fjalëkalimet, celësat dhe nuk ka asnjë pretendim ndaj palës shitëse.

2.5 Me lidhjen e kontratës, palës blerëse i kalojnë detyrimet dhe të drejtat përkatëse.

Jey


### Neni 3

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

3.1 Të dyja palët do të përpiqen të zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore. Në rast se nuk arrihet një marrëveshje miqësore midis subjekteve dhe kontrata përfundon nga njëra palë, pala tjetër do ta referojë çështjen në gjykatën e Kopetente në rastin konkret kompetente është Gjykata e Shkallës së Parë Durrës.

Kontrata lexohet me nga secila palë dhe nënshkruhet në shenjë miratimi.

Shitës



Blerës

INDRIT LAMA  
Tey